

NE E RRISIM NIVELIN E DEMOKRACISË



DEMOKRACIA, LIRIA E POPULLIT

LEONITA (14), ELVIRA (14), ELDINI (13), ALTINI (13), RINESA (13), RREZE (13)



Lexues të dashur, nga ky artikull do të mësoni për rolin që e kemi ne në një shtet demokratik

Të jetosh në një shtet demokratik është e lehtë, sepse të gjitha të drejtat e popullit janë të barabarta, pa marrë parasysh gjininë, fenë, racën, etj. Por, këto të drejta nuk kanë qenë të barabarta në fillimet e para të demokracisë, përkatësisht në vitin 507 p.e.s., sepse të drejtën e votës e kishin vetëm të pasurit dhe burrat. Demokracia është qeverisje e popullit, sepse populli vet vendos për mënyrën e qeverisjes së një vendi. Roli aktiv i secilit qytetar është i pashmangshëm në ndërtimin dhe zbatimin e elementeve të demokracisë. Sigurisht se iu interesojnë se cilat janë elementet përbërëse të demokracisë, e këto elemente janë: liria, toleranca, të drejtat e barabarta, respekti, paqja, përgjegjësia, barazia, etj.

Dy format më të njohura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese.

Demokracia përfaqësuese ka dy sisteme: sistemin parlamentar dhe sistemin presidencial.

Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, sepse populli zgjedh deputetët, ndërsa deputetët të cilët janë zëri i popullit e zgjedhin Presidentin e vendit. Detyra e deputetëve është përfaqësimi i interesave të popullit. Në ndërtimin e demokracisë duhet të kontribuojë secili qytetar, në mënyrë që të gjithë të ndihen më të lumtur dhe më të barabartë. Edhe pse, ne nuk e kemi të drejtën e votës deri në moshën 18 vjeçare, roli ynë në ndërtimin e demokracisë vërehet dukshëm. Si për shembull, roli ynë vërehet në respektin që kemi ndaj të tjerëve, në tolerancën që e tregojmë, si dhe në bashkëpunimin që ne si nxënës e tregojmë me mësuesit dhe me qytetarët e tjerë. Qytetarë të dashur, mendoni sa më shumë për të ardhmen e shtetit tonë, sepse vetëm kështu mund të bëjmë ndryshime pozitive.



Mendimet tona për demokracinë



Ne jemi e ardhmja e vendit

KUVENDI DHE RËNDËSIA E TIJ

ALTINA (13), DIELLZA (13), EDONI (14), ENISI (13), KALTRINI (13), UKSHINI (13)

Në artikullin tonë, të dashur lexues, do të informoheni më shumë rreth Kuvendit dhe rëndësisë së tij si institucion, po ashtu edhe ndikimin që ky institucion ka në jetën tonë

Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë ligjvënës, sepse në këtë institucion përveç që diskutohen dhe shqyrtohen projektligje të ndryshme, po ashtu bëhet miratimi (mos miratimi) i këtyre projektligjeve. Në rast se këto projektligje miratohen, atëherë kalojnë në ligje, të cilat duhet zbatuar nga të gjithë qytetarët. Kjo na bën të kuptojmë se këto ligje ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tonë. Por, si mund të ndikojnë ato? Që të kuptojmë më mirë se si kanë ndikim këto ligje në jetën tonë, ne menduam si shembull të marrim ligjet, të cilat kanë të bëjnë me edukimin në Kosovë. Shteti ynë i obligon të gjithë qytetarët që të vijojnë edukimin fillor dhe atë të mesëm të ulët. Po ashtu, është duke punuar që edhe arsimit i lartë të

bëhet i obligueshëm. Kjo sepse, një edukim i lartë dhe i mirëfilltë do të jetë çelësi i një shteti përparimtar. Mirëpo, shtrohet pyetja, kush e gëzon të drejtën e propozimit të këtyre projektligjeve? Të drejtën për propozim të projektligjeve, përpos deputetëve e gëzojnë edhe Presidenti, Qeveria si dhe një numër i madh i qytetarëve, afër 10.000 qytetarë. Pra, siç po e shihni të dashur lexues, këtu secili institucion luan rol të madh në jetën tonë.


Por, si hallka më e rëndësishme e tërë kësaj pa dyshim se është Kuvendi, sepse në këtë institucion kuvendojnë të zgjedhurit e popullit. Këta deputetë janë zgjedhur me vota të lira dhe të drejta. Pra, deputetët janë zëri i popullit.




Ne mendojmë se bashkëpunimi është çelësi drejt një të ardhme të ndritur të një vendi

Kuvendi, si institucioni më demokratik që është, ka funksione, detyra dhe përgjegjësi të shumta.

Disa nga detyrat e Kuvendit janë: miratimi i buxhetit të Kosovës, i cili propozohet nga Qeveria dhe zgjedhja e Presidentit të Kosovës. Ndërsa, funksionet e Kuvendit janë: funksioni kontrollues që e ushtron ndaj Qeverisë, të cilin e bën përmes pyetjeve që deputetët iu parashetrojnë ministrave, të cilët janë të pranishëm në seancë; funksioni i përfaqësimit të popullit, sepse deputetët i përfaqësojnë qytetarët të cilët i kanë votuar; si dhe funksioni i miratimit të ligjeve, pra, bën miratimin, por mund të bëjë edhe mos miratimin e projektligjeve. Ne jemi shumë të lumtur që edhe vendi ynë, Kosova ka institucione siç është Kuvendi.




Përmes votës janë të zgjedhur deputetët e Kuvendit të Kosovës. Në Kuvend, kuvendojnë 120 deputetë



Të dashur lexues, edhe ju nëse jeni mbi moshën 18 vjeçare, mund të kandidoni për deputet. Unë kandidova!

PUSHTETIN E KEMI NE NË DORË

LAURESA (14), BLERONA (13), LEONITA (14), ARDITA (13), ORGES (13), BLEND (14)



Sot kemi mësuar për zgjedhjet dhe nëse doni të dini më shumë rreth tyre mund të shikoni artikullin më poshtë

Nga diskutimi në grup të vogël, ne kuptuam se zgjedhjet organizohen në një vend demokratik. Në vendet të cilat kanë demokraci përfaqësuese, të gjithë qytetarët që janë mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të votojnë të preferuarit e tyre. Në Kosovë ekzistojnë dy lloje të zgjedhjeve. Ato janë zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet

hur ata. Ne mendojmë se është shumë e rëndësishme që të zgjedhim kandidatët më të mirë për deputetë, sepse ata përpos që na përfaqësojnë neve, ata zgjedhin në emrin tonë Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin dhe Presidentin e vendit tonë. Kjo e bën Kosovën të ketë demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar. Ndërsa, vendet si Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo Franca kanë sistem presidencial, që do të thotë se qytetarët e këtyre vendeve zgjedhin me vota të lira dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë Presidentin e vendit.

Ne, sikur gjithë shtetet e tjera demokratike kemi të drejtën e votës. Por, tek pjesa e votimit duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare, sepse jemi më të vetëdijshëm për zgjedhjet tona dhe dijmë më shumë rreth jetës politike të vendit tonë.

Në vendin tonë të votosh nuk është obligim ligjor, prandaj ne nuk dënohemi nëse nuk marrim pjesë në zgjedhje, mirëpo të votosh është përgjegjësi qytetare.



qendrore. Në zgjedhjet lokale, të cilat ndryshe quhen edhe komunale, votojmë për kryetarin e komunës dhe asambleistët. Asambleistët janë qytetarë të një komune, të cilët janë përzgjedhur të punojnë në asambleenë komunale. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore qytetarët e Kosovës votojnë për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Në Kuvend punojnë 120 deputetë. Detyra e këtyre deputetëve është të përfaqësojnë qytetarët e vendit. Kjo sepse janë qytetarët e vendit ata të cilët i kanë zgjed-



Gazetarët e këtij artikulli të mrekullueshëm

Në këtë pjesë të artikullit, ne kemi shkruar për zgjedhjet tona si fëmijë, të cilat për ne janë shumë të rëndësishme

Çfarë zgjedhim ne si fëmijë ?

Ne zgjedhim rrobat, të cilat i veshim çdo ditë. Ne zgjedhim shkollën e mesme, ku do të vijojmë mësimet. Ne gjithashtu mund të zgjedhim profesionin, i cili na pëlqen më shumë. Përpos kësaj, ne zgjedhim kryetarin e klasës dhe të shkollës. Në këtë mënyrë ne zgjedhim dhe vendosim për të ardhmen tonë.

Si qytetarë të Kosovës, ne gëzojmë edhe të drejtën e lëvizjes, prandaj ne jemi të lirë të vizitojmë edhe vende të tjera. Ne vendosim se ku do t'i kalojmë pushimet verore, ose se si do të kalojmë kohën tonë të lirë.

Prandaj, ne themi se pushteti është i varur nga ne dhe ne vendosim për përfaqësuesit e shtetit tonë. Derisa ne vendosim për të ardhmen e vendit tonë, ne jemi të barabartë pa dallim: race, gjinie, feje, aftësie, kombi, etnie, gjendje ekonomike, apo prejardhje.



Ne jemi jeta e demokracisë



Pa zgjedhje të lira, nuk ka demokraci




Kandidati për deputet duke diskutuar me popullin



Zgjedhjet janë...



Ne votojmë nga moshë 18 vjeçare



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Skënder Emërllahu“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Ramjan, Viti